

KROÇERA “ARION” NË PORTIN DETAR TË DURRËSIT, LUNDRIMI I TRETË I KËTIJ SEZONI TURISTIK

-213 TURISTË NGA FRANCA, BRITANIA E MADHE DHE SHBA, VIZITA NË DURRËS, TIRANË DHE KRUIJË-

Në portin detar të Durrësit ka mbërritur sot në orët e para të mëngjesit kroçera “Arion” me 213 turistë të huaj, ndër të cilët 125 nga Franca, 40 nga Britania e Madhe, 5 nga SHBA, 2 nga Austria, etj.

Kroçera “Arion” nën kujdesin e APD u ankorua në kalatën 5 dhe grupet turistike më pas i janë drejtuar me autobuzë qyteteve të Tiranës dhe Krujës, ndërsa një pjesë po vazhdojnë vizitat në qendrat arkeologjike dhe muzeale të qytetit antik të Durrësit.

Ky është lundrimi i tretë radhazi i anijes turistike drejt porti detar të Durrësit dhe sipas agjencisë pritëse ajo do të vijë e mbushur me turistë edhe 15 herë të tjera brenda shtatorit të këtij viti.

Turistët e kroçerës “Arion” kanë mbërritur nga porti i Kotorrit (Mali i Zi) në kuadër të një ture 10-ditor në portet e Adriatikut dhe sot në mbrëmje do të vijojnë lundrimin drejt Greqisë.

“Arion” vjen në Durrës për të tretin vit radhazi dhe numri i lundrimeve është rritur nga viti në vit. Autoriteti Portual i Durrësit APD-ës ka marrë të gjitha masat për krijimin e kushteve lehtësuese për ankorimin e kroçerave, jahteve dhe motoskafeve me turistë, të cilët zgjedhin të vizitojnë qytetin bregdetar të Durrësit dhe portin më të madh të vendit.

Durrësi është bërë vitet e fundit një nga stacionet e përhershme të itinerareve ballkanike dhe mesdhetare.

Kjo është kroçera e pestë që ankorohet në Durrës brenda pak javësh.

